



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS LEPOSAVIQ

Numri i lëndës: 2021:245210

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05556528

P.nr.132/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Leposaviq - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Qëndresa Tahiri - Islami, me bashkëpunëtoresh profesionale Edita Koliqi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit G.S, për shkak të veprës penale: Sulmi nga neni 184 paragrafi 3, pika 3.1 lidhur me paragrafin 1 të Kodit (Nr.06/L-074) Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2650/19, të datës 02.11.2021, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 19.03.2024, në mungesë të Prokurorit të Shtetit Arjan Xhema, të dëmtuarës S.S, si dhe në prezencën e të akuzuarit G.S, me datë 19.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 08.04.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

G.S, nga i ati S..., e ëma S..., e vajzërisë J..., i lindur me datë, në N... P..., me adresë të vendbanimit në fshatin Z..., Komuna e L..., ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal të identifikimit, serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 06.08.2019, rreth orës 15:10 në Leposaviq, në kafenenë “Libero”, me dashje ka përdorur forcë ndaj një personi tjetër – viktimës së pambrojtur, në atë mënyrë që pas një keqkuptimi të mëparshëm ka goditur disa herë gruan e tij të pamartuar, e cila tani është e

dëmtuara S.S, një herë me xhaketë të hapur dhe një herë me xhaketë të mbyllur në zonën e kokës,

-Me këtë ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 par.3, pika 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 40, 42, 44, 43, 69 lidhur me nenin 184 par.3, pika 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe neneve: 358, 364, 449, 462 të KPP-së, të akuzuarit, i:

SHQIPTON

-DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej dy (2) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Gjykata në bazë të nenit 44 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të pandehurit, dënimin me burg në kohëzgjatje prej dy (2) muajve, i zëvendësohet në:

-DËNIM ME GJOBË në shumë prej 400 (katërqind) euro, të cilin dënim - gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veproj në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj në dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.

-OBLIGOHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (20) euro, po ashtu edhe në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

-Pala e dëmtuar S.S, për kërkesën pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko - civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.2650/19, të datës 02.11.2021, kundër të akuzuarit G.S, për shkak të veprës penale: Sulmi nga neni 184 par.3, pika 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 19.03.2024, në të cilën ka prezantuar Prokurori i Shtetit Arjan Xhema, e dëmtuara S.S, i akuzuari G.S dhe përkthyesi gjyqësor Hysen Mikullovc.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, Gjyqtarja e vetme gjykuese e ka njoftuar të pandehurin lidhur me të drejtat e tij në këtë çështje penale dhe pasi që është bindur se i pandehuri i ka kuptuar udhëzimet e gjykatës, të njëjtit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që në këtë seancë i pandehuri lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se ndjehet fajtor dhe se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës. Ka shprehur keqardhje dhe pendim për rastin e ndodhur, ka theksuar se tani me ish bashkëshorten kemi raporte të mira dhe më nuk jetojmë bashkë.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ngase pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare, dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësen e tij, konform dispozitave ligjore te nenit 242 të KPP-së, pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

E dëmtuara S.S lidhur me pranimin e fajësisë, i ka propozuar gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë, ka shtuar se sa i përket anës së saj çdo gjë është në rregull pasi me atë person nuk jetojnë më.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i akuzuari, e në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, në këtë drejtim ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e fajësisë për të akuzuarin.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti fillestar i incidentit me numër te rastit 2019/SE/078 i datës 06.08.2019; Raporti i policisë me numër te rastit 2019/SE/078 i datës 06.08.2019; Deklarata e viktimës S.S e datës 06.08.2019; Deklarata e të pandehurit G.S e datës 06.08.2019; Shënimi zyrtar me numër te rastit 2019/SE/078 i datës 06.08.2019; si dhe shkresat tjera të lëndës.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të këtyre provave dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i' u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lartë, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari G.S ka kryer veprën penale: Sulmi nga neni 184 par.3, pika 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, e për të cilën veprë është paraparë dënimi me burgim deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave rënduese lehtësuese dhe për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-së. Gjykata, si rrethana rënduese gjykata vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale, dashjen e tij, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tij në këtë veprë penale, sjelljen e mëparshme të tij. Ndërsa si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar se i njëjti ka treguar sjellje të mirë në gjykatë, keqardhjen dhe pendimin e shprehur për rastin e ndodhur, ka bashkëpunuar plotësisht me organet e rendit dhe drejtësisë që nga fillimi i procedurës kundër tij, duke kontribuar kështu në zbardhjen e shpejtë dhe të plotë të këtij rasti. Ndërsa, si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprën penale që në hapje të shqyrtimit fillestar të çështjes.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burgim ndaj të akuzuarit, pastaj i zëvendësuar me gjobë me pëlqimin e të akuzuarit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurin. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 par.1 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Për kërkesën pasurore juridike, gjykata ka vendosur në mbështetje të nenit 462 të KPP-së, ashtu që palën e dëmtuar e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko – civil.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 lidhur me par.1 dhe nenit 452 par. 1 të KPPK-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 358, 364, 449, 462 të KPPK-ës, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Leposaviq

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal

P.nr.132/2021, datë 08.04.2024

Bashkëpunëtore profesionale

Edita Koliqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Qëndresa Tahiri - Islami

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.